

TEMA : PERVOJA TE MIRA TE CIKLIT FILLOR.

-material i përgatitur për konferencën rajonale të arsimit-

Peshkopi 26/06/2006

Çështjet :

- Mësuesi dhe kurrikula e re**
- Probleme të mësimdhënies**
- Çështje të organizimit të punës në shkollë**
- Refleksione**
- Mendime të mësuesve, nxënësve, prindërve**

Përgatiti

Teuta KARAJ

Zv/Drejtoreshë e Shkollës “31 Korriku” -Burrel

Cikli fillor mbetet themeli i arsimit ne teresi. Zhvillimi historik i arsimit i jep pervoja te pasura ne ecurine gjithmone ne progres te ketij cikli masiv, perfshire edhe vitet kur struktura e kesaj hallke te arsimit nuk ishte i njejte, unike, si ne zonat urbane edhe ato rurale. Problemet e ecurise dhe arritjeve te ciklit fillor mendojme ti trajtojme ne keto drejtime kryesore:

- 1- Mesuesi dhe kurrikula e re .
- 2- Probleme te mesimdhenies.
- 3- Çeshtje te organizimit te punes ne shkolle.
- 4- Refleksione-mendime te mesuesve , nxenesve e prinderve.

1 - Mesuesi dhe Kurrikula e re

Cikli fillor , kjo hallke shume e re e sistemit arsimor na del perpara me nje kurrikul te konsoliduar , qe çdo vit e me mire forcon aspekte te ndryshme te kurrikules ne pergjithesi dhe te specifikave kurrikulare te çdo shkolle ne veçanti. Por tani e kemi fjalen per ciklin fillor aktual, aq masiv e te detyruar, per zbatimin me perpikmeri te programit unik shteteror te ketij cikli, duke synuar standarte bashkekohore.

Zbatimi me rreptesi dhe plotesimi i metejshem i i kurrikules shkollore me veçorite dhe tiparet e saj kerkon mesues te afte qe pervesojne ne menyre aktive konceptet baze te te gjitha fushave qe kerkojne programet aktuale te ciklit fillor.

Ne pergjithesi, ne ciklin fillor, ka klasa me nje mesues ne te gjitha lendet . Per kete qellim mesuesi i shkolles eshte nje mjeshter polivalent i afte qe t'u mesoje nxenesve teresine e disiplinave qe behen ne shkollen fillore.

- ❖ Ai ka perkushtimin ne pune per te mesuar dhe edukuar nxenesit e shkolles fillore nga klasa e pare ne te katert.
- ❖ Ai ushtron profesionin e tij duke punuar edhe vete pa nderprerje per formimin e tij shkencor e pedagogjik.

I – Mesuesi i shkolles duhet te jete i afte qe te mesoje te gjithe nxenesit e shkolles fillore .

Ai duhet te zoteroje nje kulture te pergjitheshme e cila te mund ti lejoje qe te perdore konceptet ne pershtatje me disiplinat e mesuara ne shkollen fillore, (hapesira, koha, kerkimi shkencor, sistemi i numerimit, funksionimi i gjuhes etj) dhe , sigurisht te perdore ne menyre te qarte njohurite baze te gjuhes se folur dhe te shkruar

(ortografine, gjuhen e shkruar, mekanizmat operues)

Ai duhet te jete i afte te nxite nxenesit ne mesimin e nje gjuhe te huaj.

Duhet qe ne menyre te domosdoshme te zoteroje njohuri dhe mekanizma te mesimit ne pershtatje me te tera disiplinat qe jane ne programin e shkolles fillore (gjuhe shqipe, lexim, matematike, histori, dituri natyre, edukate shoqerore, edukim artistik dhe edukim fizik.)

Duhet te vere ne sherbim te ketij mesimi njohurite qe ai ka per zhvillimin e femijes dhe shkallen e te nxenit tek çdo femije. Per kete gje ai duhet te njohe ne menyre te perkryer etapat e zhvillimit te femijes, te kete nje njohje te mire te teorive kryesore dhe modeleve te mesimdhenies dhe te jete i afte te dalloje , te analizoje veshtiresite vetiake qe hasen me shpesh tek femija dhe ti kaperceje ato.

II- Mesuesi duhet te jete i afte te zoteroje klasen

- Ai duhet te krijojte nje klase te gjalle dhe dinamike duke shfrytezur dhe zhvilluar te gjithe potencialet e nxenesve.

Per kete:

- Te jete i afte ta beje nxenesin nje aktor gjate gjithe ores se mesimit.
- Te dije te zhvilloje aspektet shoqerore : ndihmen e ndersjellte,
- bashkepunimin, respektin ndaj shokut etj.
- Mesuesi duhet te dije te drejtoje dhe vleresoje dijet e perftuara nga nxenesit. Per kete:
- Te dije te perdore teknika te ndryshme ne klase.
- Te munde te percaktoje nje metode dhe te jete i afte ta perligje ate.
- Te analizoje pervojat.
- Te bashkepunoje me nxenesit duke formuluar me te objektivat qe duhet te arrihen.
- Te dalloje aftesite dhe veshtiresite e çdo nxenesi.
- Te mase efikasitetin e mesimdhenies se tij.

Mesuesi duhet te dije gjithashtu te percaktoje kerkesat per cdo nxenes dhe te pershtatet ne larmine e tyre, me ane te zhvillimit te planeve te veprimit pedagogjik te shumellojshem, duke patur parasysh arrijtet dhe kapacitetet vetiake.

Kurrikula shkollore shpeshhere duhet te zgjerohet nga vete mesuesi psh.ne klasen e pare , kur nxenesit njohin shkronjat lexojne dhe shkruajne, ndonese sapo kane hyre ne klasen e pare.

Nje mesues i suksesshem duhet te kujdeset ne veçanti per keta nxenes duke hartuar e zbatuar nje plan te veçante pune ne pershtatje me nivelin dhe deshirat e tyre per te mesuar.

Mesuesit qe punojne ne ciklin fillor , theksojne faktin se , natyra e vertete e mesimdhenies se tyre ndryshon vazhdimisht. Ajo behet

me emocionale, e kenaqeshme, e kendeshme dhe me nivel me te larte intelektual, kur sigurohet pjesemarrje e gjere e nxenesve ne mesim.

Si edukator duhet te mbajme parasysh se çdo nxenes qe ne mesojme eshte nje individ , produkt i kultures, i mjedisit , i shendetit , i temperamentit dhe i personalitetit te veçante . Keta faktore asnjehere nuk jane statike. Me rritjen ndodhin edhe ndryshime. Megjithate ka modele te dallueshme te zhvillimit qe shfaqen me kalimin e kohes . Disa nxenes sillen ne menyra qe jane ne nivile me te larta se sa mosha e tyre , ndersa te tjere , me aftesine e tyre njohese e tejkalojne zhvillimin moshor dhe mund te sillen ne forma te tjera. Moshja e zhvillimit eshte koha ne te cilen nxenesi peson ndryshime ne fushen shoqerore ,fizike , mendore e njohese. Eshte e zakonshme te gjejmë ndryshime ne nivelin e formimit te nxenesve te se njejtës moshe. Si edukatore qe planifikojme mjedisin e klases , mesuesit duhet te marrin parasysh keta faktore te zhvillimit , per te ndihmuar çdo nxenes te arrije zhvillimin e mundshem te tij te plote.

Nga komunikimi i rregullt dhe i vazhdueshem fitojne te gjithë, ne radhe te pare nxenesit, por edhe prinderit e mesuesit. Nxenesit perfitojne ne menyre te veçante kur verejne se te rriturit qe jane te rendesishem per jeten e tyre , bashkepunojne me ta , per te realizuar nje qellim te perbashket.

Mesuesit qe zbatojne kete forme pune , kane karakteristike te tilla si:

- Nxitin dhe pranojne autonomine dhe nismen e nxenesit . Nxenesit qe bejne pyetje dhe pastaj mobilizohen per t'iu pergjigjur atyre , behen te pergjegjeshem per mesimin e tyre dhe behen zgjidhes te problemit .
- Ata formojne shumellojshmeri materialesh duke perfshire mjete , koleksione te ndryshme , ekskursionë jashteshkollore.
- Ndjekin deshirat e nxenesëve duke sugjeruar fushat më me
- interes per t'u mbajtur parasysh gjate zbatimit te projekteve ne zhvillim, duke krijuar keshtu mesime tematike dhe duke e vene veten ne pozitat e nxenesve gjate gjithë kohës se veprimtarisë se perbashket. Pra , mesuesi mund te nxite mesimnxenie te re , duke sjelle burime e informacione ne çdo kohe te punës ne oren e mesimit dhe jashte saj .
- Fillojne zhvillimin e mesimit duke drejtuar pyetje per

- paqartesite qe mund te kene nxenesit . Kjo sherben per te marre te dhena per shkallen e informacionit qe kane ata rreth konceptit qe do te trajtohet. Me tej , nepermjet bashkebisedimit nxjerrin se çfare duan te dine nxenesit dhe si mund t'i pervesojne keto njohuri e koncepte qe permban tema.
- Nxitin nxenesit te bejne pyetje , te perfshihen ne diskutim
- dhe te perpunojne pergjigjet e tyre. Ata mbeshtesin strategjite e te mesuarit te nxenesve dhe tregojne respekt per ta, duke u lene kohe te mjaftueshme per t'u pergjigjur.

• Karakteristika te tilla mund te ndeshen edhe ne punen e perditeshme. Ato tregojne se mesuesi qe i zbaton , perdor forma te reja ne trajtimin e zhvillimin e mesimit. Ai shmanget keshtu nga format e njohura tradicionale , nepermjet te cilave nxenesi trajtohet vetem si objekt i procesit mesimor.

2- Probleme te mesimdhënies dhe te nxënies

Sipas filozofise se progresivizmit , zhvillimi psikik , personaliteti dhe aftesia per te nxene zhvillohen si rrjedhoje e nderveprimit te vazhdueshem ndermjet mjedisit dhe trashegimise gjenetike. Per kete arsye mesimdhënia dhe te nxenët jane ne funksin te njera-tjetres. Kjo arrihet kur plotesohen disa kushte:

- Mesimdhënia dhe te nxenët kane femijen ne qender . Mesuesi mban parasysh interesat , prirjet , zhvillimin individual dhe potencialin e çdo femije. Ai u krijon mundesi te gjithë femijeve per t'i zhvilluar me tej ato.
- -Te nxenët eshte proces zbulues dhe eksperimentues. Mbeshtetet ne parimin se femija meson duke bere. Te nxenët ndodh nepermjet perjekjeve aktive te ideve dha materialeve . Keto njohuri jane te nderthurura me njera-tjetren dhe jane pasqyruar ne kurrikul. Roli i mesuesit ne kete kendveshtrim eshte ai i drejtuesit dhe
- lehtesuesit te procesit te te nxenit .
- Puna perqendrohet tek individi , tek grupet e vogla te nxenesve me teper , sesa ne te gjithë klasen .
- Mesimdhënia synon zhvillimin e njohurive , te shprehive dhe
- qendrimeve pozitive dhe te argumentuara te nxenesve.
- Mesuesi i ndihmon nxenesit te ndertojne kuptimin dhe idete
- e reja per bazen e njohurive qe kane.
- Nxenesi mendon dhe nxe duke kaluar ne keto procese:
- Njohja dhe te kuptuarit.
- Perqendrimi dhe zbatimi.
- Perfytyrimi dhe krijimi.

- Ndjeshmeria dhe vleresimi.
- Nxenesi motivohet dhe perdor strategjine e duhur per te arritur kuptimin.
- Nxenesi edukohet si te punoje , te mesoje dhe te nxere, duke qene edhe i pavarur, gjate gjithë jetes, ne apo pas viteve te shkollimit.
- Si perfundim mund te themi se parimet mbi te cilat ndertohet te nxenet jane tri:
- Domosdoshmeria e aktivizimit te njohurive te mepareshme
- perpara se te nise nje veprimtari e re e te nxenit.
- Nevoja e motivimit si perpjekje per te nxitur te nxenet, dy
- perberesit e motivimit jane vendosja e qellimeve dhe veprimtarite qe zbatohen per ti permbushur ato.
- Perdorimi i strategjive te frytshme te te nxenit nepermjet te
- cilave te nxenet dhe te kuptuaret kane sukses.

Aftesite qe fitohen jane aftesi vetereflektuese.

Baze per sukses ne mesimdhenie dhe nxenie ne ciklin fillor eshte edhe **takti pedagogjik** . Ai duhet te pershtatet ne çdo rast me parimin : “ **Nese duam te edukojme nje qytetar te lire te nje shoqerie demokratike, duhet ta trajtojme ate si te tille qe kur eshte ende femije**”.

Takti pedagogjik ka te beje me marrëdhëniet ndërmjet mesuesit dhe nxenesve, me komunikimin e pergjithshem te tyre, te shpeshte, te drejtperdrejte. Si e tille eshte teper e nevojshme nga mesuesi njohja e menyres se komunikimit. Ne komunikim nje element teper i nevojshem eshte takti . E thene shkurt , fjala takt eshte nje ndjenje e brendeshme e mesuesit, e cila , e dhene ne masen e duhur, na lejon te percaktojme masen , kohen, menyren, vendin e perdorimit me te drejte te fjaleve, te kerkesave , sjelljeve, veprimeve me te mira, me te shkelqyeshme, duke patur parasysh personalitetin e nxenesve qe kemi perpara per te ngjallur reagim pozitiv tek ata.

Te gjithë ne qe kemi punuar e punojme si mesues na ka rene ne sy dita e pare e shkolles. Si dita e pare qe eshte per nje 6-vjecar edhe per mesuesin , mbart me vete shume emocione.

Femije me temperamente te ndryshme , femije me prejardhje nga kopeshti, si dhe femije qe nuk kane vajtur asnje dite ne kopesht, femije me gjendje ekonomiko-sociale te ndryshme, femije qe vijne nga kendet e lojrave e te tjere qe nuk i kane provuar, femije me prinder ku niveli arsimor i tyre eshte i ndryshem. Ketu e ka zanafillen takti pedagogjik. Takti nuk ka vetem anen psikologjike, ai ka dhe anen pedagogjike. Qendrimi 45min ne klase i perqendruar , pa lodra, ne ditet e para e merzit nxenesin. Ndonje dhe mund te qaje, kerkon prinderit, kerkon edukatoren. Fillimisht ata nuk perqendrohen, duan te levizin, duan te luajne, lozin me mjetet qe kane , kendojne, vershellejne, etj.

Atehere si duhet vepruar ne keto raste nga mesuesi?

Ç’ qendrim duhet te mbaje mesuesi ndaj fenomeneve te kesaj natyre?

Ja disa situata te cilat jo rrallehere kane kerkuar taktin si nje moment i cili ka sjelle suksesin e punes ne oren e mesimit.

Nje nxenes pergjimet, vemendja e tij eshte e paperqendruar tek ajo qe shpjegon mesuesi. Takti dhe shprehjet ne funksion te tij jane:

- Beni sot qenke i gezuar, gezohem edhe une, por me te gezuar do te jemi ne fund te ores se mesimit . Me vleresimin qe do te marresh ne fund te mesimit , do te gezosh veten dhe prinderit qe mezi te presin .

Nxenesi del nga gjendja, aktivizohet nga mesuesi, nxitet nga etapa ne etape te ores se mesimit dhe se fundi motivohet per rezultatin qe arriti.

Nje nxenes tjetër ecen shume ngadale, jo me ritmin e shokeve. Ne te tilla raste mesuesi afrohet dhe i terheq vemendjen: **“ Je shume i sakte por shoket kane ecur me perpara. Se bashku, eja te arrijme ata qe nesor me forcat e tua te ecesh me shoket per t’u bere nje nxenes me i mire”**.

Nje dite tjetër mesuesi thote : **“Sot i bere per njekohe me te shkurter mesimet, je shume afer shokeve ne kohe. Perpiqu qe edhe t’ua kalosh atyre”**.

Ne pune e siper nxenes te ndryshem gabojne. Takti pedagogjik ne keto raste duhet te jete shume i kujdeseshem , sepse nxenesi edhe kur gabon meson. Mesuesi thote : **“Mire ke shkruar, shume bukur, por zgjidhja e ushtrimit nuk eshte e sakte, ke gabuar, po te me degjosh me me kujdes mua dhe po te punosh me shume gjate studimit do te kesh rezultate si te Almes, Beses, Ilirit”**.

Me vone mesuesi perdor nje shprehje tjetër : **“Te lumte, sot me kenaqe, vazhdo keshtu. Ja arrite Almes e Ilirit, ec bashke me ta”**.

Mesues te tille, me pervoje qe asnjehere ne oren e mesimit nuk perdor nje ze te zemeruar ka plote dhe shembujt do te vazhdonin gjate.

3 – Çeshtjet e organizimit te punes ne shkolle.

a- Menaxhimi i klases.

Menaxhimi i klases nuk eshte gje tjetër veçse zbatimi dhe perdorimi i te gjithave rregullave dhe procedurave per sigurimin e rregullit, disiplines dhe mbarevajtjes se mesimit ne klase.

Qe menaxhimi te jete sa me i efektshem, duhet te zbatohen disa teknika te tij.

Keto teknika te menaxhimit te klases fillojne qe ne fillim te shkolles:

- Mesuesi tregon se eshte i pergatitur per nje pune te gjate qe e pret perpara dhe se ka besim tek vetja per te realizuar qe ne ditën e pare te shkolles.
- Mesuesi i mire fillon mesimin ne ditën e pare te shkolles me nje detyre, e cila eshte shum e qarte dhe mund te kryhet ne menyre te sukseseshme nga nxenesit.
- Mesuesi demonstroi ne menyre te vazhdueshme se eshte kompetent , i pergatitur mire dhe se eshte ne krye te punes.
- Mesuesi duhet te jete profesionist, i kendshem dhe te perpiqet qe te krijojë nje atmosfer miqesore me nxenesit ne klase.
- Mesuesi duhet te tregojë se eshte ne korent me gjithçka qe

- ndodh ne klase, kjo ben qe keta mesues te kene me pak probleme ne klase, duke i krahasuar me ata mesues qe nuk jane ne dijeni te asaj qe ndodh ne klase.
- Mesuesi duhet te jete i afte per tu marre me shume gjera ne te\
- njejten kohe. Duhet ruajtur ritmi i duhur i veprimtarive ne klase. Mesuesi duhet te beje nje analize te punes te tij ne kete moment. I duhet te nmendoje se si e ka menaxhuar klasen gjate nje periudhe te caktuar te dites mesimore.
- Mesuesi duhet te perpiqet te perfshije ne mesim te gjithë
- nxenesit edhe ateherë kur ai punon me nje nxenes te veçantë.
- Mesimi duhet organizuar me variacione. Ne rastet kur shihet
- se ne oren e mesimit nuk shkon diçka, mesuesi duhet te perpiqet te ndryshoje materialin qe eshte duke dhene, duke e bere ate me te lehte dhe me te kuptueshem per nxenesit.

Menaxhimi i klases ka lidhje te ngushte me sjelljen e mesuesit Per kete mesuesi duhet te jete i drejte me nxenesit, te zoteroje mire lenden, te kontrolloje emocionet e tij, te ndihmoje nxenesit ne rast nevojë, te ndjeke ecurine e nxenesve gjate kryerjes se detyrave etj.

Nga pervoja e vezhgimeve, mund te themi se mesuesi yne, jo rralle humbet shume kohe ne oren e mesimit, humbje e cila ndodh jo vetem si rrjedhoje abuzive, po mbi te gjitha nga aftesite e kufizuara menaxhuese te klases.

Mesuesi yne ende nuk ka kuptuar se ne kushtet e zhvillimit te vrullshem shoqeror dhe te rritjes mahnitese te informacionit, koncepti per mesimdhënien ka ndryshuar. Mesuesi nuk mund te luaje me rolin e burimit te informacionit si dikur, por ai ne menyre te pashmangeshme eshte pozicionuar si udheheqes dhe organizues i mesimit qe udheheq nxenesin per te kerkuar e mbledhur informacionin ne menyre te drejtuar apo te pavarur duke e paisur me metodologjine e studimit dhe perpunimit te ketij informacioni.

Pikerisht ne keto momente shfaqet aftesia e menaxhimit te klases nga ana e mesuesit, aftesi e cila duhet te karakterizohet nga vezhgimi i kujdeseshem, vleresimi i sjelljeve ne klase, gadishmeria per t'iu pergjigjur ne kohe sjelljeve te papershtateshme duke u prirur drejt krijimit dhe ruajtjes se nje klime pozitive dhe sa me te pershtateshme ne procesin e mesimdhënies ne klase.

4- Refleksione-opinione te mesuesve , nxenesve e prinderve.

Si drejtuese e CU per nje periudhe relativisht te gjate kohore ne shkollen 9 vjeçare “31 Korriku “ Burrel – nje shkolle me tradita ne fushen e mesimdhënies,nga moria e pervojave dhe eksperiencave,do te veçoj dy nga me pikantet,dhe qe mendoj se I vlejne çdo mesimdhëniesi ne ciklin fillor.

-Mesuesja e talentuar Z.Farie Kuka,nxenesit e se ciles kane fituar edhe çmime nderkombetare,ne menyre te padiskutueshme mund te quhet “dekane” e ciklit fillor jo vetem ne shkollen 31 Korriku,por edhe me gjere.

Mesuesja e nderuar ne klase prezanton nje aktore,dhe kete gje jua indukton edhe nxenesve te saj.Kyçi suksesit te saj bazohet ne dy shtylla:

- Se pari ne planifikimin vjetor te çdo lende,ne percaktimin adekuat te objektivave per çdo lende,per çdo kapitull,dhe per çdo teme mesimore.E gjithë kjo veprimtari parapergatitore behet para fillimit te vitit akademik.
- Se dyti lidhja organike dhe logjike e koncepteve ,apo njohurive,te cilat sipas programit jepen ne trajte spirale.Çdo nxenes I klases se saj ka te depozituar ne nje dosje te veçante te gjitha punimet,apo veprimtarite e kryera,te cilat riperdoren nga ana e mesueses,kur keto njohuri rimerren ne po ate klase ,apo ne nje klase me te larte.

Çdo ore mesimi e saj fillon me veprimtari,e cila mbeshtetet ne punimet e tyre te meprashme,te cilat jane te ruajtura ne dosjet personale.

Gjate ores se mesimit shihet qarte pershkallezimi I veprimtarive me nxenesit ,duke kaluar nga veprimtari konkrete ,e mbeshtetur me mjete didaktike,ne veprimtari meta konkrete,e mbeshtetur me vizatime e skica,per te kaluar me ne fund ne abstraksione,duke u mbeshtetur ne simbole.

Nje pervoje tjeter ,e vlefshme dhe me impakt pozitiv ne mesimdhenie ,eshte ajo e prezantuar nga mesuesja aktuale e klases se I te shkolles 31 Korriku – Adelina Vata – “Puna me grupe”.

Duke patur parasyshe se ka nxenes,qe njohin shkronjat,qe ne ditet e para te shkolles,mesuesja I ndan nxenesit ne grupe,duke perfshire ne secilin prej tyre nxenes te ketij niveli.Mesuesja nga ana e saj udhezohet dhe drejton nxenesit ne ,qe ne fazen e pare pergatitore te abetares.Nxenesit udhezohen te kryejne veprimtari te tilla si emertimin dhe shqiptimin e tingujve,lidhjen e tingullit me shkronjen perkatese,formimin e fjaleve te caktuara me shkronja dhe rrokje levizore;duke kaluar me vone ne veprimtari dhe detyra me te veshtira.

Edhe detyrat e shtepise ,qe mesuesja u cakton nxenesve jane te diferencuara dhe jane te lidhura me nivelin e njohurive,qe ata zoterojne.

Nga nje test I zbatuar ne kete klase jane arritur te merren keto rezultate :

1 – Ne te lexuar:

a- Nxenesit shume te mire lexojne 60 – 90 fjale ne minute

b- Nxenesit mesatare lexojne 30 – 50 fjale ne minute

c- Nxenesit e dobet lexojne nen 30 fjale ne minute

2- Ne te shkruar:

- a-Nxenesit shume te mire krijojne fjali ne menyre individuale,u pergjigjen me saktesi pyetjeve dhe pershkruajne figura.
- b-Nxenesit mesatare gabojne ne 6 – 7 fjale ne diktim,krijojne me veshtiresi fjali,mund te gabojne ne pergjigje.
- c-Nxenesit e dobet nuk arrijne te prodhojne te shkruarin e kuptimshem,shkruajne gjysmat e fjaleve,shkruajne sakte fjalet me rrokje te hapura e te shkurtra.

Me poshte po japim ne menyre te shkurtuar disa opinione te mesuesve , nxenesve e prinderve te atyre klasave te cilet punojne me metoda te reja bashkekohore ku ne qender eshte nxenesi dhe te nxenet nderveprues ne klase.

Opinione te mesuesve : "... ne fillim me eshte dukur se metodat klasike jane te pazevendesueshme, por shume shpejt kuptova se te nxenet nderveprues, te gjitha ato teknika ne menyren me te persosur i nderrojne metodat klasike. Gjate ores te gjitha nxenesit jane aktive, shume te lire dhe pjesemarres te barabarte ne mesim.

Pas perdorimit te ketyre metodave dhe teknikave edhe suksemi ne klase dukshem u permiresua edhe nxenesit e dobet ju bashkengjiten atyre te mireve"

" anet pozitive te ketyre metodave dhe te formave te te nxenit jane te shumta psh.

1- Nxenesit shprehin deshire te madhe te punojne ne grupe sepse ndihen te lire, deshirojne te bashkepunojne dhe te shprehin idete e tyre.

2- Para se ti vleresojme ne ata, ata vleresojne njeri-tjetrin.

3- Prinderit shprehin kenaqesi dhe pajtim me kete pune, me metoda te reja.

4- Por ora mesimore shpesh eshte e shkurter prej 45min".

....."duke i zbatuar teknikat e reja te te nxenit nderveprues punen kryesore e bejne vete nxenesit me ane te aktiviteteve, lojrave, punes me grupe dhe zoteron me shume lenden".

Opinione te nxenesve : "Per mua keto metoda jane mjaft ineresante, mesimi eshte mjaft i kuptueshem si per mua ashtu dhe per shoket e shoqet".

"Puna ne grupe eshte me e mire, sepse me shume mbahet ne mend dhe i ndihmohet atij qe nuk di, mendoj se keshtu eshte shume mire. Punojme me shoket e shoqet dhe çdo gje shkon mire. Shoket e shoqet me ndihmojne kur une nuk di diçka, por edhe une i ndihmoj ata".

Opinione te prinderve: "Po verehet nje ndryshim tek femijet e mi, do te thote shume me lehte po kuptojne dhe jane me te kenaqur sidomos me punen ne grupe, po verej nje vullnet. Jemi te kenaqur dhe deshirojme qe edhe me tutje te punohet ne kete drejtim".

"Une si prinder i dy femijeve kam vene re se metodat e reja te mesimit qe zbatohen nga mesuesit e lendeve te ndryshme, kane sjelle nje freski te re tek femijet e mi. Tani interesimi i femijeve eshte me i madh per te mesuar dhe punuar ne menyre me te perkushtuar, prandaj deshiroj qe keto teknika te mesimit te vazhdojne edhe me tej".

Le te jete ky sugjerim i ketij prindi nje udheheqje e punes tone si Mesues i brezit te ri.